



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 100, datë 19.05.2022

“PËR PRANIMIN E ANKIMIT”

Në mbështetje të nenit 3, 4 dhe 49 të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 113, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 189 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë” i ndryshuar, nenet 24 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë pasi u njoh me ankesën e zotit Ilir Hoxha, prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, kundër vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë “Mbi pranimin e kërkesës së shtetasit Agron Tepelena për zëvendësimin e prokurorit” të datës 14.04.2022, paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nëpërmjet kërkesës së regjistruar me Nr.928 prot., datë 16.05.2022, bazuar në relacionin e paraqitur për shqyrtim nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankimit të zotit Ilir Hoxha në lidhje me Vendimin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë “Mbi pranimin e kërkesës së shtetasit Agron Tepelena për zëvendësimin e prokurorit” të datës 14.04.2022.
2. Shfuqizimin e vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë “Për pranimin e kërkesës së shtetasit Agron Tepelena për zëvendësimin e prokurorit” të datës 14.04.2022.
3. Relacioni shpjegues është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë vendim zoti Ilir Hoxha dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 19.05.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
ALFRED BALLA

ZV/KRYETAR
TARTAR BAZAJ



ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
MIRELA BOGDANI